



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 38, datë 23.05.2016

Për

“MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME NR.1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT, DREJTORINË E PËRGJITHSHME NR.2 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT DHE AGJENCINË E PARQEVE DHE REKREACIONIT”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 23 pika 9, nenit 27 pika 1, nenit 54 shkronjat “ç”, “dh”, nenit 55 pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 140, nenit 149 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitim të trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 41, datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 31.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”; Urdhrit nr. 14431, datë 05.10.2015 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, (i ndryshuar); Urdhrit nr.3188/1, datë 01.02.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhrit nr.3185, datë 01.02.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës”; kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr. prot 1346, datë 26.04.2016 (protokolluar pranë Bashkisë së Tiranës me nr. prot 13037, datë 28.04.2016); kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit me nr. prot 1757, datë 05.05.2016 (protokolluar pranë Bashkisë së Tiranës me nr. prot 13703, datë 06.05.2016); kërkesës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me nr. prot 684, datë 03.05.2016 (protokolluar pranë Bashkisë së Tiranës me nr. prot 13700, datë 05.05.2016), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një numër prej 40 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2016 për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, për një periudhë 4 mujore (Qershor-Tetor) për mirëmbajtjen dhe vaditjen e sipërfaqeve të gjelbëra, si dhe

24 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për një periudhë 2 mujore (Tetor-Dhjetor) për mbjellje dhe kultivim bimësie, me pagë bruto 30.000 lekë në muaj.

2. Të miratojë një numër prej 50 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit për një periudhë 2 mujore (Maj – Qershor) për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes e kullimit, pas periudhës së shirave si dhe për një periudhë 2 mujore (Tetor – Nëntor) pas përfundimit të periudhës së verës, me pagë bruto 30.000 lekë në muaj.
3. Të miratojë një numër prej 20 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2016 për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit për një periudhë 4 mujore (Qershor - Tetor) për realizimin e aktiviteteve dhe proceseve të punës të planifikuara, për favorizimin dhe zhvillimin e bimësisë dekorative për shkak të kushteve klimaterike dhe vegjetacionit, me pagë bruto 30.000 lekë në muaj.
4. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1, nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit për vitin 2016.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI